

## RELACION

### PËR

### PROJEKTLIGJIN

## "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 35/2016 PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO"

### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përmes projektligjit "Për disa ndryshime në ligjin nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" propozohet të shtohen, ndryshohen dhe përshtaten dispozita me qëllim përafrimin e Direktivave të Bashkimit Evropian dhe rregullimin e mënyrës së funksionimit të Agjencive të Administrimit Kolektiv (AAK).

A. Ligji nr. 35/2016 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" është një ligj i harmonizuar dhe i integruar me Direktivat e Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, lind nevoja e përafrimit të këtij ligji me tri direktiva të Bashkimit Evropian si më poshtë vijon:

- (1) Direktivën Nr. 2012/28 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 25 tetor 2012, "Për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor";
- (2) Direktivën 2017/1564 (BE) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 13 shtator 2017, "Mbi disa përdorime të lejuara të veprave të caktuara dhe fusha të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara";
- (3) Amendimin e Direktivës 2001/29/KE mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në shoqërinë e informacionit." Direktivën 2011/77/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian, datë 27 shtator 2011 "Amendimi i Direktivës 2006/116/KE mbi afatin e mbrojtjes të të drejtave të autorit dhe disa të drejtave të lidhura me to".

Krijimi i një kuadri ligjor për mundësimin e digjitalizimit të veprave që mbrohen nga e drejta e autorit ose të drejta të tjera të lidhura me to, për të cilat nuk ka mbajtës të së drejtës të identifikuar ose për të cilat mbajtësi i të drejtës edhe kur identifikohet, nuk mund të gjendet - të ashtuquajturat "vepra pa autor" - përbën një masë themelore të planit digjital për Evropën. Direktiva Nr. 2012/28 synon të zgjidhë problemin konkret të përcaktimit ligjor të statusit të veprës pa autor dhe të pasojave përkatëse në lidhje me përdoruesit dhe përdorimet e lejuara të veprave apo të fonogrameve që konsiderohen si vepra pa autor.

Nënvizohet dhe theksohet që e drejta e autorit përbën themelin ekonomik për industrinë krijuese, duke qenë se nxit risitë, krijimtarinë, investimin dhe prodhimin. Digjitalizimi në masë dhe përhapja e veprave përbën kësisojë një formë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. E drejta e autorit është një mjet i rëndësishëm për të siguruar që sektori krijues të përfitojë shpërblimin për veprën e tij.

*Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet përafrimit të Direktivës Nr. 2012/28 janë:*

- a. Të përcaktohet statusi i “veprave pa autor” nëpërmjet kërkimit shterues.
- b. Të bëhet riprodhimi i “veprave pa autor” nga institucionet për qëllime të digjitalizimit, si dhe duke i vendosur ato në dispozicion të publikut, të indeksuara, të kataloguara, të ruajtura ose të restauruara.
- c. Të rregullohet mënyra e përdorimit dhe përcaktimi i institucioneve të lejuara për përdorimin e tyre.
- d. Të njihet e drejta dhe mënyra e kompensimit të autorit ose bashkautorit të veprës, pas përfundimit të statusit si “vepër pa autor”.
- e. Të krijohet një bazë të dhënash online për “veprat pa autor”.

*Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet përafrimit të Direktivës nr. 2017/1564 janë:*

- a. Rritja e disponueshmërisë së librave dhe materialeve të tjera të printuara në formate të përshtatshme e të aksesueshme për personat e verbër, persona me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara.
- b. Lehtësohet identifikimi dhe bashkëpunimi mes personave të autorizuar, përfitues, subjektet e autorizuar publike apo private, të cilët janë të autorizuar të përdorin dhe realizojnë kopje në format të përshtatshëm e të aksesueshëm për personat e verbër, personat me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara.
- c. Të përcaktojë rregulla për të parandaluar shpërndarjen, komunikim me publikun ose vënien në dispozicion të publikut të kopjeve të veprave me të drejtë autori në format të përshtatshëm në mënyrë të pautorizuar.
- d. Të parashikojë përjashtime për të drejtat ekskluzive të të drejtës së autorit në lidhje me riprodhimin, shpërndarjen, vënien në dispozicion të publikut dhe huadhënien e veprave të përshtatshme për personat e verbër, personat me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara.
- e. Të promovojë përdorimin dhe njohjen e krijimeve artistike duke krijuar mundësi aksesimi për personat me aftësi të kufizuara brenda rregullave të caktuara.

Direktiva 2011/77/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian, datë 27 shtator 2011 “Amendimi i Direktivës 2006/116/KE Mbi afatin e mbrojtjes të të drejtave të autorit dhe disa të drejtave të lidhura me to” nga verifikimet e kryera nga grupi i punës për hartimin e projektligjit,

si dhe pas hartimit të tabelave të përputhshmërisë, rezulton se është përafëruar pjesërisht në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

**B.** Nisur nga problematikat e evidentuara gjatë zbatimit në praktikë të dispozitave mbi funksionimin e Agjencive të Administrimit Kolektiv dhe duke mbajtur në konsideratë se roli dhe funksionimi i tyre sipas ligjit ka një rëndësi themelore për zbatimin e të drejtave të autorit, propozohet të ndryshohen / saktësohen dispozitat lidhur me përfaqësimin e administrimit të të drejtave nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv (në vijim AAK), shmangien e konfliktit të interesit dhe mënyrën dhe përqindjen e ndarjes së tarifës dhe shpërblimit të mbledhur ndaj AAK-ve.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj është hartuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare dhe angazhimeve të ndërmarra nga Ministria e Kulturës në kuadrin e hartimit dhe përmirësimit të akteve ligjore dhe nënligjore. Drejtoria për të Drejtën e Autorit (DDA) në Ministrinë e Kulturës ka detyrimin të raportojë mbi zhvillimet në fushën e të drejtës së autorit, pranë Komisionit Evropian dhe respektivisht në Nën-Komitetin e Tregut të Brendshëm dhe të Konkurrencës dhe në Komitetin e Asocim–Stabilizimit, Shqipëri-Bashkim Evropian (KSA). Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, konkretisht kapitulli 7 parashikon forcim të mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Intelektuale dhe sigurim të një niveli mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian. Harmonizimi i direktivës Nr. 2012/28 është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2020 -2022, ndërsa harmonizimi i direktivave 2011/77/BE dhe 2017/1574 është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2020 -2022. Në zbatim të Marrëveshjes së Asociim –Stabilizimit, në nenin 73 të saj “Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale”, Shqipëria duhet të sigurojë në njëjtin nivel mbrojtjeje si ato të vendeve të Bashkimit Evropian.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME**

1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka asnjë rregullim ligjor lidhur me “veprat pa autor” dhe asnjë bazë të dhënash lidhur me këto vepra. Përcaktimi dhe trajtimi i “veprave pa autor” është një koncept i ri në Republikën e Shqipërisë.

Aktualisht mungojnë rregullat për digjitalizimin e “veprave pa autor”. Në ligjin aktual nuk ka asnjë dispozitë e cila parashikon sesi kryhet digjitalizimi dhe përdorimi i veprave dhe të objekteve të tjera që mbrohen nga e drejta e autorit ose të drejta të tjera të lidhura me të, për të

cilat nuk ka mbajtës të së drejtës të identifikuar, ose për të cilat mbajtësi i të drejtës edhe kur identifikohet, nuk mund të gjendet.

Ky projektligj synon të sjellë një zgjidhje sa i takon problemit konkret të përcaktimit ligjor të statusit të “veprës pa autor” dhe të pasojave përkatëse në lidhje me përdoruesit dhe përdorimet e lejuara të veprave apo të fonogrameve që konsiderohen si “vepra pa autor”.

Gjithashtu, rezulton se në Republikën e Shqipërisë ka përdorim të veprave të cilat mund të konsiderohen si “vepra pa autor”. “Vepra pa autor” mund të jenë libra, artikuj gazetash, fotografi etj. Pra, “veprat pa autor” rezultojnë të jenë vepra të cilat publiku i gjerë mund t’i përdorë. Për këtë, paraqitet e nevojshme të rregullohet mënyra e përdorimit nga institucionet e lejuara për përdorimin e tyre, në mënyrë që më pas këto institucione t’ua vënë në dispozicion publikut. Nisur nga fakti se në Republikën e Shqipërisë “veprat pa autor” përdoren, ngrihet problematika se kujt do t’i merret leja/autorizimi për këto vepra. Në këtë aspekt ky projektligj rregullon edhe procedurat e marrjes së statusit si “vepër pa autor”, si dhe përdorimin e tyre. Gjithashtu, parashikohen edhe institucionet që do të autorizohen për të kryer kërkimin shterues me qëllim dhënien e statusit “Vepër pa autor”.

Gjithashtu, një problem tjetër është edhe kompensimi i autorit, i cili vendos të përfundojë statusin e “veprës pa autor”. Ky projektligj përcakton se çfarë ndodh në rast se mbajtësi i të drejtës së autorit bëhet i njohur ose i gjendet vendndodhja. Kështu, autori mund të përfundojë statusin e “veprës pa autor” në lidhje me të drejtat e tij. Gjithashtu, parashikohet edhe mënyra e përcaktimit të shumës së kompensimit, e cila do të përcaktohet sipas kategorive të “veprave pa autor”, duke marrë parasysh, ndër të tjera, qëllimet e promovimit kulturor, natyra jo fitimprurëse e përdorimit të bërë nga institucioni përkatës, qëllimet që kanë të bëjnë me misionet e tyre me interes publik, të tilla si përhapja e kulturës, si dhe dëmet e mundshme që mund t’iu shkaktohen autorëve.

2. Ligji nr. 35/2016 në nenin 77 të tij ka të parashikuar përdorimin e veprave të destinuara për personat me aftësi të kufizuara. Ky projekt ligj sjell përkufizime të reja për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu përcakton mënyrën e përdorimit të lejuar dhe realizimin e kopjeve në format të aksesueshëm nga personat përfitues apo subjektet e autorizuara që i shërbejnë nevojave të tyre dhe nga subjektet e autorizuara publike apo organizata private, në veçanti libraritë, institucionet arsimore dhe organizata të tjera jo-fitimprurëse, që u shërbejnë personave me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara, si një ndër veprimtaritë e tyre kryesore, detyrim institucional apo si pjesë e misionit të tyre në interes të publikut. Ky projektligj përcakton detyrimet që duhet të përmbushin subjektet e autorizuara të cilat shpërndajnë, komunikojnë tek publiku ose vënë në dispozicion të publikut kopje në formate të përshtatshëm të aksesueshëm për personat e verbër, persona me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara.

3. Propozohet riformulimi i nenit 135 të ligjit nr. 35/2016, konkretisht propozohet që fjalia e parë e pikës 2 të nenit 135 të shfuqizohet, pasi parashikimi i prezumimit të përfaqësimit të të gjithë mbajtësve të së drejtës sipas kategorive **bie në kundërshtim me parashikimin e pikës 1 të nenit 132, ku përcaktohet se agjencia e administrimit kolektiv do të administrojë të drejtat e autorëve vetëm në bazë të një kontrate të lidhur me autorin.**

**Në kuptim të pikës 2 të nenit 135 (neni që propozohet të shfuqizohet) “prezumimi” nënkupton që një AAK përfaqëson sipas kategorisë së caktuar të gjithë mbajtësit e të drejtave, anëtarë ose jo, duke mos faktuar shpërndarjen e pjesës takuese tek të gjithë sipas përdorimit të veprës.**

Shfuqizimi i fjalisë së parë të pikës 2 të nenit 135 parashikohet të sjellë një rregullim të situatës, si për agjencitë e administrimit kolektiv, të cilat do të mbledhin dhe do të shpërndajnë vetëm për anëtarët e tyre **në bazë të një kontratë**, si dhe për përdoruesit, të cilët do të jenë shumë më të qartë në detyrimet e tyre për të drejtën e autorit.

Nga monitorimet e kryera tek Agjencitë e Administrimit Kolektiv në Republikën e Shqipërisë, konstatohet se sistemi i Administrimit Kolektiv të zgjeruar është një sistem i cili nuk përshtatet me mënyrën e funksionimit dhe ushtrimit të veprimtarisë të AAK-ve të licencuara në Shqipëri. Kjo për arsyet se AAK-të nuk garantojnë një monitorim dhe eksperiencë në lidhje me të drejtat e autorit të cilat mbledhen në bazë të prezumimit. Faktorët negativë të evidentuar janë si më poshtë:

- Mungesë transparence, e cila ka patur fokus mbledhjen e të ardhurave dhe jo shpërndarjen e tyre;
- Mungesë transparence në mbledhjen e tarifave për përdorimin e të drejtës së autorit;
- Është kontaktuar mungesë besimi e përdoruesve të të drejtës së autorit në sistemin e menaxhimit kolektiv në Shqipëri.
- Përdoruesit nuk janë të qartë në detyrimet e tyre dhe përcaktimin e tarifës për të drejtën e autorit;
- AAK-të mund të jenë duke mbledhur shpërblimin për përdorimin e veprave, mbajtësit e të cilave kryejnë administrimin e të drejtave të tyre në mënyrë individuale ose kanë hequr dorë nga administrimi kolektiv.
- AAK-të mund të jenë duke mbledhur shpërblimin për përdorimin e veprave, për të cilat mbajtësit e të drejtës nuk kanë pasur asnjëherë qëllime përfitimi apo të cilat kanë qenë të lira për përdorim nga publiku.

- AAK-të mund të jenë duke mbledhur të ardhura për përdorime të të drejtave të autorit, për të cilat mbajtësit e së drejtën nuk kanë pasur asnjëherë qëllime përfitimi apo të cilat kanë qënë të lira për përdorim nga publiku;

Referuar dokumenteve strategjike të Bashkimit Evropian (*Impact Assessment* të sistemit të menaxhimit kolektiv të zgjeruar) AAK-të duhet të garantojnë që jo-anëtarët të jenë të mirë informuar për ushtrimin e të drejtave si dhe përfitimin që kanë përkundrejt përdorimit të veprave të tyre. Rezulton që ky përfitim nuk shpërndahe tek jo-anëtarët nga agjencitë.

Fjalja e dytë e pikës 2 të nenit 135 nuk ndryshohet, sepse është në përputhje me pikën 4 të nenit 5 të direktivës 2014/26/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, data 26 shkurt 2014, "*Për administrimin kolektiv të së drejtës të autorit e të ngjashme, dhe mbi licencimin shumëterritorësh të të drejtave për veprat muzikore për përdorim përmes internetit në tregun e brendshëm*".

Në ligjin aktual sporteli unik (SUADA) kryen funksionin e mbledhjes së tarifave për të gjitha agjencitë e administrimit kolektiv me pritshmëritë e rritjes së të ardhurat dhe shpërblimet për autorët. Nga monitotimi i AAK-ve dhe SUADA-s evidentohet se nuk është realizuar qëllimi kryesor i krijimit të Agjencisë unike - kryerja e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve dhe ndarja e kësaj tarife të mbledhur ndaj AAK-ve. Gjithashtu, nuk është garantuar efikasiteti, impakti dhe efektet e pritshme për përmirësimin e të ardhurave në sektorin e industrive krijuese, të ardhurat dhe shpërndarjet janë në vlera të ulta dhe jo për të gjitha AAK-të e licencuara, kostot e administrimi janë të larta në kundërshtim me ligjin nr. 35/2016 dhe ka mungesë të theksuar bashkëpunimi dhe ekuilibri mes AAK-ve.

**Përzgjedhja e agjencisë drejtuese është vendosur në të gjitha rastet me vendimmarrje të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, në mungesë të një marrëveshje mes agjencive.** Mungesa e arritjes së një marrëveshje midis AAK është evidentuar edhe lidhur me shpërndarjen e të ardhurave që i takojnë kategorisë së autorëve e përcaktuar në nenin 138 të ligjit nr. 35/2016 "*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*", ka sjellë anomali në mbarëvajtjen e punës së Sportelit Unik SUADA.

**Konkretisht neni 138/3 i ligjit nr. 35/2016 përcakton mënyrën dhe përqindjen e ndarjes së tarifës dhe shpërblimit të mbledhur ndaj AAK-ve si më poshtë:**

- a) 40 për qind do t'i shkojë agjencisë, përfaqësuesi i të drejtave të autorit;
- b) 30 për qind do t'i shkojë agjencisë, përfaqësuesi i të drejtave të interpretuesve;
- c) 30 për qind do t'i shkojë agjencisë, përfaqësuesi i të drejtave të prodhuesve, përfshirë botuesit dhe prodhuesit e fonogrameve.

**Situata faktike lidhur me germën a) të nenit 138/3.** Ndarja e 40 për qind për dy agjencitë e licencuara nuk është kryer. Agjencitë e administrimit kolektiv nuk kanë arritur në dakordësi për

ndarjen dhe përpjesëtimin e drejtë e të barabartë të tarifave të mbledhura mbi të drejtën e autorit. Kjo mënyrë ndarje bie në kundërshtim me parimin e shpërblimit për të drejtën e autorit sipas përdorimit dhe jo me përbindje apo shuma fikse.

Për sa më lart propozohet ndryshime në nenin 138 të ligjit nr. 35/2016 si më poshtë:

**Pika 1 e nenit 138** përcakton qëllimin e krijimit të agjencisë unike e cila do të kryejë funksionin e mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave në administrimin kolektiv dhe lëshimin e lejeve/autorizimeve tek subjektet përdorues, nen i cili aktualisht mungon.

**Pika 2 e nenit 138** përcakton organizimin e Sportelit Unik. Sporteli unik do të përbëhet nga përfaqësues të të gjithë agjencive të administrimit kolektiv, anëtarë të bordit vendimarrës. Propozimi i ri parashikon që të mos ketë një agjenci drejtuese në krye të sportelit unik, SUADA, në mënyrë që vendimmarrja të jetë e balancuar për të siguruar shpërndarjen e drejtë mes të gjithë anëtarëve. Transferimi i funksionit të mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave, një agjencie drejtuese krijon njëanshmëri dhe lë hapësira për krijim mosmarrëveshjeje, duke ndikuar në shpërndarje jo të duhur të tarifave të shpërblimit.

**Pika 3 e nenit 138** në projektligjit përcakton se Agjencitë e Administrimit Kolektiv përzgjedhin organin më të lartë ekzekutiv, jo nga radhët e agjencive të administrimit kolektiv, por një drejtor ekzekutiv të pavaruar. Në këtë mënyrë shmanget çdo lloj interesi mbi aktivitetin e AAK-ve. Ky propozim është në përputhje të plotë me nenin 10 të Direktivës 2014/26/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, data 26 shkurt 2014, "*Për administrimin kolektiv të së drejtës të autorit e të ngjashme, dhe mbi licencimin shumëterritorësh të të drejtave për veprat muzikore për përdorim përmes internetit në tregun e brendshëm*", e cila përcakton, citohet:

“Detyrime në lidhje me drejtimin e agjencive të administrimit kolektiv

1. *Duhet siguruar që çdo organizatë e menaxhimit kolektiv të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që personat që administrojnë biznesin e saj ta bëjnë këtë në mënyrë të shëndoshë, të kujdesshme dhe të përshtatshme, duke përdorur procedura të shëndosha administrative dhe financiare dhe mekanizma të kontrollit të brendshëm*
2. *Shtetet Anëtare sigurojnë që organizatat e menaxhimit kolektiv të krijojnë dhe të zbatojnë procedurat për të shmangur konfliktin e interesave, dhe kur konflikte të tilla nuk mund të shmangen, të identifikojnë, menaxhojnë, monitorojnë dhe paraqesin konfliktet aktuale ose të mundshme të interesit ...”.*

Bordi i drejtorëve të SUADA-s përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha Agjencive të Administrimit Kolektiv të licencuara. Konstatohet se Drejtuesi ekzekutiv i SUADA-s është njëkohësisht edhe përfaqësues në vendimmarrjen e Bordit Drejtues dhe drejtor ekzekutiv i SUADA-s. Sa më sipër, në mbështetje të propozimit për ndryshimin e nenit 138, referojmë pikën 25 të Direktivës 2014/26/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, data 26 Shkurt 2014 “Mbi administrimin kolektiv”, ku sqarohet: “*Një Organizatë e Administrimit Kolektiv, për të qënë funksionale duhet të marrë masa për të evituar konfliktin e interesit dhe të garantojë integritetin e bordit të drejtorëve dhe*

*administratës e AAK-së dhe ushtrimi i detyrës duhet të jetë i pavarur. Drejtuesit, të zgjedhur apo të punësuar përmes një kontratë, duhet të deklarojnë... konfliktin e interesit... ”*

**Pika 4 e nenit 138** në projektligj përcakton se, në rast se nuk arrihet marrëveshja mes AAK-ve, përzgjedhjen e organit më të lartë ekzekutiv të Sportelit Unik e realizon KKDA-ja.

Mbledhja e tarifave të shpërblimit do të kryhet nga agjencia unike bazuar në metodologjinë e miratuar të tarifave. Agjencia unike pajis përdoruesit, në vijim të kërkesave të tyre, me kontrata në formën jo-ekskluzive për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, në këmbim të një shpërblimi, me kontratë të shkruar, brenda tagrave të përcaktuar dhe kategorive që mbulon secila nga agjencitë e administrimit kolektiv e licencuar. AAK-të vendosin në dispozicion të agjencisë unike çdo informacion të nevojshëm në mënyrë që kjo e fundit të kryejë funksionin e saj të mbledhjes së shpërblimeve.

**Pika 7 e nenit 138** të projektligjit përcakton se shpenzimet e sportelit unik nuk mund të tejkalojnë tavanin 15 përqind. Kjo shumë e shpenzimeve do të përlllogaritet duke u zbritur nga shpenzimet e secilës prej AAK-ve. Neni 151 i ligjit 35/2016 përcakton se, citohet: *“Shpenzimet totale të një AAK-je nuk mund të përbëjnë më shumë se 30 përqind të shpërblimeve të shpërndara. Shuma e përgjithshme e shpenzimeve të një shoqate apo çdo forme tjetër juridike OJF-je do të përfshijë edhe mjetet financiare të shpenzuara në përmirësimin e sistemit të administrimit dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të. Përveç shpenzimeve të tilla të bëra, organet e agjencisë mund të vendosin për të shpenzuar maksimumi 3 përqind të shumës totale të shpërblimeve të grumbulluara mbi masat kundër piraterisë dhe falsifikimit, si dhe për masat e tjera që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të vlerës së të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të.”*

Agjencitë e Administrimit Kolektiv vendosin në dispozicion të Sportelit Unik të gjithë informacionin e nevojshëm dhe bazën e të dhënave me të gjithë anëtarët me të cilët janë lidhur kontrata, të shoqëruara me listën e veprave të mbrojtura. Sporteli Unik kryen mbledhjen e shpërblimeve bazuar në listat e anëtarëve të AAK-ve. Mbledhja e shpërblimit të subjektet përdorues kryhet në mënyrë të drejtë e të përpjesëtuar me vlerën dhe përdorimin konkret të veprave e të objekteve të të drejtave të lidhura (**pika 8**).

**Pika 9 e nenit 138** në projektligj përcakton se mungesa e transparencës, e dhënies së informacionit apo veprime të tjera të AAK-ve të cilat sjellin pengesa në mbarëvajtjen e veprimtarisë të Sportelit unik do të sjellin marrjen e masave penalizuese për AAK-në.

Së fundi, neni 159 i ligjit aktual, i cili përcakton mbikëqyrjen e veprimtarive të AAK-ve, është i paqartë në lidhje me përcaktimin e procedurave për pezullimin për 6 muaj të licencës apo deri në heqjen e saj në rast se konstatohet se veprimtaria e AAK-ve nuk është në përputhje me dispozitat ligjore.

Për këtë qëllim, është propozuar që pika 5 e nenit 159 të ligjit aktual të riformulohet duke shfuqizuar afatin 30 ditor për rregullimin e të metave të konstatuara. Një procedurë



administrative e cila fillon kryesisht është e mirëpërcaktuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”. Në vijim, nëse konstatohet se veprimaria e AAK-së është në kundërshtim me përcaktimet ligjore, duhet të fillojë procedura administrative sipas parashikimeve ligjore dhe jo të kërkohet rregullimi i të metave.

Në vijim të këtij arsytimi është e nevojshme që kjo procedurë të rregullohet me akt nënligjor dhe propozohet që pas pikës 6 të nenit 159 të shtohet pika 7 ku të përcaktohen se kushtet dhe procedura për pezullimin e licencës së AAK-ve do të përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit.

Neni 177 mbi Kodet e standardeve dhe konformitetit të produkteve që lidhen me zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtat e lidhura shfuqizohet, pasi nuk gjen interpretim dhe për rrjedhojë as aplikim në Republikën e Shqipërisë.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.35/2016,”Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht me nenet 78 dhe 83, pika 1. Projektligji i paraqitur është në harmoni me gjithë rendin juridik të brendshëm e ndërkombëtar.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BASHKIMIT EUROPIAN**

Ky projektligj ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *acquis* e Bashkimit Europian dhe me realizimin e objektivave të Republikës së Shqipërisë në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

Qëllimi i përafrimit të Direktivës nr. 2012/28 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit Europian, datë 25 tetor 2012, “Për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor” është përcaktimi i statusit të “veprës pa autor”, si dhe mënyra e përdorimit të tyre nga bibliotekat me akses publik, institucionet arsimore dhe muzetë, si dhe nga arkivat, institucionet e trashëgimisë filmike ose zanore dhe organizatat transmetuese të shërbimit publik që ndodhen në shtetet anëtare, për të arritur synimet në lidhje me misionet e tyre në interes të publikut.

Kjo direktivë nuk duhet të prekë të drejtat e mbajtësve të të drejtës së identifikuar dhe që u dihet vendndoshja. Nëse, pas kryerjes dhe dokumentimit të kërkimit shterues jo të gjithë bashkëautorët e një vepre janë identifikuar ose nëse janë identifikuar dhe u dihet vendndodhja, zbatohen parashikimet e këtij projektligji. Të drejtat e bashkëautorëve të identifikuar dhe që u dihet

vendodhja do të mbeten të pa cenuara duke dhënë autorizimin e tyre për riprodhimin dhe vënien në dispozicion të publikut për një vepër të tillë.

Qëllimi i përafrimit të Direktivës nr. 2017/1564 “*Mbi disa përdorime të lejuara të veprave të caktuara dhe fusha të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara, dhe amendimin e Direktivës 2001/29/KE mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në shoqërinë e informacionit.*” është përcaktimi i mënyrës së përdorimit të kopjeve të përshtatshme të aksesueshme nga personat fizikë apo subjektet e autorizuara pa autorizimin e autorit të një vepre apo titullarit të së drejtës së autorit për këtë vepër dhe pa shpërblim.

Hartimi i këtij projektligji vjen si pasojë e nevojës për të përmirësuar kuadrin ligjor në mënyrë që të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to të kenë një zbatim rigoroz, si dhe zbatimi i ligjit të ketë më shumë stabilitet e gjithëpërfshirje në Republikën e Shqipërisë.

Shkalla e përafrimit me Direktivën 2017/1564 është e pjesshme. Neni 4 i Direktivës parshikon lejimin e shkëmbimit mes shteteve anëtare të Bashkimit Evropian të kopjeve në një format të përshtatshëm të një vepre për të siguruar një disponueshmëri më të madhe në të gjithë tregun e brendshëm. Ky përcaktim i Direktivës nuk është përafuar në këtë projektligji.

Ndryshimet në dispozitat mbi administrimin kolektiv synojnë harmonizimin me legjislacionin ndërkombëtar mbi të drejtën e autorit, midis të tjerash me Direktivën 2014/26/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, data 26 shkurt 2014 “Mbi administrimit kolektiv”, dhe vlerësohen gjithashtu në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT LIGJIT**

Projektligji është i përbërë nga 13 (trembëdhjetë) nene, si më poshtë:

- **Neni 1 i projektligjit** përcakton Direktivat që do të përafrohen në ligjin nr 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të cilat i bashkohen direktivave të tjera.
- **Neni 2 i projektligjit** parashikon se në pikën 2 të nenit 5, pas fjalëve “përjashtimet dhe kufizimet e së drejtës së autorit” shtohen fjalët “veprat pa autor dhe kërkimi shterues”.
- **Neni 3 i projektligjit**, parashikon që pas nenit 16 të ligjit shtohen 3 nene, konkretisht nenet 16/1, 16/2, dhe 16/3, të cilat rregullojnë konceptin e “veprës pa autor”, kur asnjë nga autorët ose bashkautorët e një vepre nuk është identifikuar, nëse autori ose një a më shumë bashkautorë të veprës janë identifikuar, por asnjërit prej tyre nuk i dihet vendndodhja. Në kuptim të direktivës “Vepër pa autor” konsiderohet vepra kur, pas kryerjes dhe regjistrimit të një kërkimi shterues në kuptim të nenit 16/2, asnjë nga autorët ose bashkautorët e një vepre

nuk janë identifikuar, ose edhe nëse autori ose një nga bashkautorët e veprës janë identifikuar por asnjërit prej tyre nuk i dihet vendndodhja, do të zbatohet neni 75/1 i këtij ligji.

Ky proces ndodh vetëm pas kryerjes dhe dokumentimit të një kërkimi shterues. Kërkimi shterues kryhet përpara përdorimit të veprës, duke kërkuar tek burimet që janë të përshtatshme për kategorinë përkatëse të veprave. Me qëllim përcaktimin nëse një vepër apo fonogram është një vepër pa autor, institucionet e përmendura në nenin 16/3 të ligjit organik duhet të sigurojnë që është kryer një kërkim i plotë lidhur me secilën vepër të mbrojtur, duke konsultuar burimet e duhura për kategorinë e veprave të mbrojtura në fjalë. Kërkimi i plotë kryhet përpara përdorimit të veprës ose fonogramit.

Në rastet kur autorët janë identifikuar dhe që u dihet vendndodhja dhe kanë lëshuar autorizimin e tyre për riprodhimin dhe vënien në dispozicion të publikut, të drejtat e tyre mbeten të pacenuara.

Kategoritë e veprave të përcaktuara në pikën 3 të nenit 16/1, janë:

- a) vepra të botuara në formën e librave, gazetave, revistave ose shkrimeve të tjera të përfshira në koleksionet e bibliotekave që janë të aksesueshme nga publiku, të institucioneve arsimore dhe muzeve, të personave të tjerë juridikë që kryejnë veprimtari muzeore, si dhe në koleksionet e arkivave ose të institucioneve arkivore filmike ose audiovizuale;
- b) veprat kinematografike ose vepra të tjera audiovizuale të përfshira në koleksionet e institucioneve që janë të aksesueshme nga publiku, të institucioneve arsimore dhe muzeve, të personave të tjerë juridikë që kryejnë veprimtari muzeore, si dhe në koleksionet e arkivave ose të institucioneve arkivore filmike ose audiovizuale;
- c) veprat kinematografike ose vepra të tjera audiovizuale të prodhuara nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) deri në 31 dhjetor 2002 të cilat janë të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe që gjenden në arkivat e tyre publikohen për herë të parë në Republikën e Shqipërisë ose, në mungesë të publikimit, transmetohen për herë të parë në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, sipas pikës 4 të nenit 16/1, zbatohen edhe për ato vepra të cilat nuk janë publikuar ose transmetuar ndonjëherë, por që për herë të parë janë bërë të njohura në publik nga institucionet e sipërcituara, por vetëm me pëlqimin e autorëve, me kushtin që, në mënyrë të arsyeshme, të mendohet se autorët e këtyre veprave nuk do të kundërshtonin përdorimin e referuar në nenin 3, të këtij projektligji.

Pika 7 e nenit 16/1 njeh parimin e reciprocitetit që do të thotë se një vepër që konsiderohet vepër pa autor në përputhje me ligjin e çdo shteti anëtar të Bashkimit Evropian, do të konsiderohet gjithashtu një vepër pa autor edhe në Republikën e Shqipërisë, pa qenë nevoja për të kryer procedurën e kërkimit shterues.

Neni 16/2 rregullon procedurën që duhet ndjekur nga institucionet përgjegjëse për kërkimin shterues për qëllimin e identifikimit ose gjetjes së vendndodhjes së autorëve ose bashkautorëve ose dhënies së statusit të veprave pa autor. E gjithë procedura ku do

mbështeten këto institucione është parimi i mirëbesimit. Kërkimi shterues do të kryhet përpara përdorimit të veprës, duke kërkuar tek burimet që janë të përshtatshme për kategorinë përkatëse të veprave.

Pika 1 e nenit 16/3, në bazë të kategorive të veprave ka bërë një ndarje të burimeve, konkretisht:

- a) Për librat e botuar burime të përshtatshme janë: Depozitimet e kopjeve të detyruara, në veçanti i bibliografisë kombëtare, katalogëve të bibliotekave, leksioneve biografike, të dosjeve dhe të bazave të të dhënave bibliografike të mbajtura nga bibliotekat dhe institucionet e tjera; bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i mbajtur nga institucionet arkivore, shoqatat e botuesve dhe autorëve në Republikën e Shqipërisë; bazat e të dhënave ekzistuese dhe regjistrat nga shkrimtarët, artistët dhe mbajtësit e tyre të të drejtave së autorit, ISBN (International Standard Book Number) dhe bazat e të dhënave që listojnë libra për printim; bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i agjencive përkatëse të administrimit kolektiv, në veçanti agjencia e administrimit kolektiv për të drejtat e riprodhimit; burime që integrojnë bazat e të dhënave dhe regjistrave të shumëfishtë, duke përfshirë Bibliotekën Botërore Digjitale (World Digital Library) dhe Regjistrat e të Drejtave të Informacionit dhe Veprave pa Autor – ARROW) si dhe Portalin Online Europeana. burime që tregojnë bazat e të dhënave, informacion dhe koleksione nga organizata dhe autoritete ndërkombëtare partnere të bibliotekave..
- b) Për gazetatat, revistat, ditaret dhe periodikët burime të përshtatshme janë: ISSN (International Standard Serial Number) për botime periodike; indekset dhe katalogët nga fondet bibliotekare dhe koleksionet; depozitimet e kopjeve të detyruara, në veçanti nga bibliografitë kombëtare të veçanta; bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i mbajtur nga institucionet arkivore, nga shoqatat e botuesve, autorëve dhe gazetarëve në Republikën e Shqipërisë; bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i agjencive përkatëse të administrimit kolektiv, në veçanti agjencia e administrimit kolektiv për të drejtat e riprodhimit; leksionet biografike;
- c) Për veprat e artit pamor, përfshirë artet e bukura, fotografinë, ilustrimin, dizajnin, arkitekturën, skicat, krijimet hartografike burime të përshtatshme janë: burimet e referuara si më sipër; bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i agjencive përkatëse të administrimit kolektiv, në veçanti agjencia e administrimit kolektiv për veprat e arteve pamore dhe ajo për të drejtat e riprodhimit; sipas rastit, bazat e të dhënave të organizatave dhe institucioneve arkivore dhe të fotografisë.
- d) Për veprat audiovizuale, shfaqjet, veprat e vendosura në fonograme dhe videograme burime të përshtatshme janë: depozitim ligjor; bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i mbajtur nga agjencitë kolektive të prodhuesve në Republikën e Shqipërisë; bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i institucioneve arkivore filmike ose audiovizuale dhe bibliotekave kombëtare; bazat e të dhënave me standardet përkatëse dhe identifikues si mund të jetë Standardi Ndërkombëtar Audiovizual për materialin audioviziv, Kodi Ndërkombëtar i Veprës Muzikore për veprat muzikore dhe Kodi Ndërkombëtar i

Regjistrimit Standard për fonograme; bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i agjencive përkatëse të administrimit kolektiv, në veçanti për autorët, interpretuesit, prodhuesit e fonogramit dhe prodhuesit audiovizualë; shënime dhe informacione të tjera që paraqiten në materialin e veprës ose në lëndën e paketimit të të drejtave të lidhura; bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i organizatave të tjera përkatëse që përfaqësojnë një kategori të veçantë të mbajtësve të të drejtave.

Sipas pikës 2 të nenit 16/2 një kërkim shterues kryhet kur vepra është botuar për herë të parë ose, në mungesë të botimit, transmetuar për herë të parë në Republikën e Shqipërisë. Institucionet përkatëse duhet të mbajnë evidenca dhe të dhëna për kërkimet shteruese të kryera, si dhe t’jua komunikojnë ato Drejtorisë për të Drejtën e Autorit (DDA) pranë Ministrisë së Kulturës. DDA-ja krijon, regjistron dhe administron bazën e të dhënave të vetme publike online, të veprave pa autor. Evidencat dhe të dhënat duhet të përfshijnë rezultatet e kërkimeve shteruese që kanë kryer institucionet, përdorimi që këto institucione bëjnë për veprat pa autor, çdo ndryshim në statusin e veprave pa autor ose objekteve të së drejtave të lidhura që përdoren nga institucionet, si dhe informacionin përkatës të kontaktit të institucionit në fjalë.

- **Neni 4 i projektligjit**, riformulon nenin 75 të ligjit për sa i përket kufizimeve në përfitimin e institucioneve të veçanta. Ky nen zgjeron dhe saktëson konceptin e “përdorimit të brendshëm” për riprodhimin e veprës të autorit nga institucionet e përmendura në nenin 75 të ligjit.
- **Neni 5 i projektligjit**, parashikon që pas nenit 75 të ligjit shtohen 2 nene, konkretisht nenet 75/1 dhe 75/2.

Neni 75/1 rregullon mënyrën e përdorimit të veprave pa autor. Pika 1 e tij shprehet se bibliotekat publike, institucionet arsimore ose muzetë, personat e tjerë juridikë që kryejnë veprimtari muzeore, arkivat, institucionet arkivore filmike ose audiovizuale dhe ofruesit e shërbimit mediatik audiovizual - OSHMA që janë krijuar në Republikën e Shqipërisë mund të riprodhojnë vepra pa autor që janë të përfshira në koleksionet e tyre për qëllime të digjitalizimit, si dhe duke i vendosur ato në dispozicion të publikut, të indeksuara, kataloguara, ruajtura ose restauruara. Ato mund t’i vendosin në dispozicion të publikut vetëm për të arritur qëllimet që kanë të bëjnë me misionet e tyre me interes publik, në veçanti, ruajtjen, restaurimin dhe sigurimin e aksesit kulturor dhe arsimor për veprat pa autor të përfshira në koleksionet e tyre. Institucionet e sipërpërmendura mund të përfitojnë të ardhura gjatë përdorimeve të tilla të veprave pa autor, për qëllimin e vetëm të mbulimit të kostove të tyre të digjitalizimit dhe t’i vendosë ato në dispozicion të publikut. Nuk pengohen marrëveshjet e partneritetit publik-privat sipas legjislacionit në fuqi. Në çdo rast, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të tregojnë respektivisht autorin e identifikuar dhe bashkautorët e këtyre veprave, për rastin e autorit që nuk i dihet vendndodhja.

Neni 75/2 rregullon të drejtën e kompensimit për përdorimin e veprës pa autor. Gjithashtu, sqaron rastet e përfundimit të statusit të veprës pa autor. Autori ose bashkautor i veprës, që

sipas pikave 1 deri në 5 të nenit 16/1 të ligjit konsiderohet një veprë pa autor, në çdo kohë, mund të përfundojë, zbatimin e statusit të veprës pa autor në lidhje me të drejtat e tij.

Konkretisht pika 1 shprehet se autori ose bashkautori, i cili vendos të përfundojë statusin e veprës pa autor gëzon të drejtën për kompensim të drejtë për përdorimin që i është bërë veprës së tij nga institucioni përkatës i parashikuar. Shuma e kompensimit do të përcaktohet sipas kategorive të veprave pa autor, duke marrë parasysh, ndër të tjera, qëllimet e promovimit kulturor, natyra jo fitimprurëse e përdorimit të bërë nga institucioni përkatës, qëllimet që kanë të bëjnë me misionet e tyre me interes publik, të tilla si promovimi i mësimnxënies dhe përhapjes së kulturës, si dhe dëmet e mundshme që mund t'iu shkaktohen autorëve. Kërkesa mund të paraqitet nga autori ose AAK-ja përkatëse me autorizim të autorit. Procedura dhe mënyra e kompensimit do të rregullohet me VKM. Sipas pikës 5, dispozitat e këtij neni nuk do të ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e fituara nga dispozitat e tjera ligjore në lidhje me të drejtat e tjera.

- **Neni 6 i projektligjit** parashikon që pas nenit 77 në ligjin nr. 35/2016 shtohen nenet 77/1 dhe 77/2.

Në nenin 77/1 përcaktohen një sërë përkuzimesh si: “vepra të destinuara për personat me aftësi të kufizuara”, “person përfitues”, “kopje e një vepre në një format të përshtatshëm”, “subjekt i autorizuar”. Pika 2 e nenit 77/1 përshkruan përdorimin e lejuar nga “personat e autorizuar” apo “subjektet e autorizuar”. Përdorimet e lejuara mbulojnë të drejtën e një personi përfitues, apo përfaqësues i tij, për të bërë kopje në një format të përshtatshëm të një vepre të botuar në mënyrë të ligjshme, për qëllim të përdorimit ekskluziv nga një person përfitues, si dhe përdorimin e lejuar nga një subjekt i autorizuar për të bërë kopje në një format të përshtatshëm të një vepre të botuar në mënyrë të ligjshme, të përcjellë, të vendosë në dispozicion të publikut, të shpërndajë ose të japë hua kopje të formatit të përshtatshëm tek një person përfitues ose subjekti tjetër i autorizuar pa qëllime përfitimi ekonomik, për qëllim të përdorimit ekskluziv nga një person përfitues. Kopja në një format të përshtatshëm duhet të respektojë tërësinë e veprës duke mos cenuar nderin, personalitetin dhe reputacionin e autorit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Në këtë projektligj përcaktohen detyrimet e subjektit të autorizuar duke parashikuar se çdo kopje në formatin e përshtatshëm të autorizuar do të kryhet me qëllim të komunikojë, të bëjë të disponueshme, shpërndajë ose japë hua kopje të formatit të aksesueshëm tek një person përfitues ose subjekti tjetër të autorizuar mbi baza jo-fitimprurëse për qëllim të përdorimit ekskluziv nga një person përfitues.

- **Neni 7 i projektligjit**, përcakton se pika 2 e nenit 135 të ligjit riformulohet.
- **Neni 8 i projektligjit**, përcakton riformulimin e nenit 138 sa i përket sportelit unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve, duke marrë në konsideratë problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të dispozitës aktuale.
- **Neni 9 i projektligjit**, parashikon se pika 5 e nenit 159 riformulohet.
- **Neni 10 i projektligjit** parashikon shfuqizimin e nenit 177 të ligjit.

- **Neni 11 i projektligjit**, parashikon se në pikën 5, të nenit 187, pas fjalëve “Pika 8, e nenit 32,...” shtohen fjalët “...si dhe pika 4 e nenit 75/2”.
- **Neni 12 i projektligjit**, parashikon zbatimin në kohë të veprave pa autor.
- **Neni 13 i projektligjit**, parashikon hyrjen në fuqi dhe konkretisht është parashikuar afati prej 3 muajsh pas botimit në Fletoren Zyrtare, me qëllim njohjen e tij nga institucionet dhe subjektet e interesuara.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Kulturës. Ky projektligji është hartuar nga Ministria e Kulturës, konkretisht me Urdhër nr. 64, datë 04.02.2020, të Ministrit të Kulturës “Për ngritjen e grupit të punës, për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Grupi i punës, i ngritur me Urdhër të Ministrit, ka punuar për përgatitjen e projektligjit për përafrimin e Direktivës 2012/28/BE të Parlamentit dhe Këshillit, të datës 25 tetor 2012, “Për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor”, Direktivës 2017/1564 (BE) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 13 shtator 2017, “Mbi disa përdorime të lejuara të veprave të caktuara dhe fusha të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara, dhe amendimin e Direktivës 2001/29/KE mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në shoqërinë e informacionit.” dhe Direktives 2011/77/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 27 shtator 2011 “Amendimi i Direktivës 2006/116/KE mbi afatin e mbrojtjes të të drejtave të autorit dhe disa të drejtave të lidhura me to”.

Për shkak të fushës së zbatimit të së drejtës së autorit dhe mbrojtjes, dhe me qëllim realizimin e këtyre ndryshimeve ligjore, institucionet që preken janë: Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Biblioteka Kombëtare, bibliotekat me akses publik, muzetë, Akademia e Shkencave, Akademia e Studimeve Albanologjike, Shoqata Shqiptare e Botuesve, Qendra Kombëtare Kinematografike, Radio Televizioni Shqiptar, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Qendra Kombëtare e Reabilitimit të të Verbërve, etj.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Për këtë projektligj ka kontribuar Ministria e Kulturës.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Në këtë projektligj është parashikuar se Drejtoria për të Drejten e Autorit, krijon, regjistron dhe administron bazën e të dhënave të vetme publike online, të veprave pa autor, të cilat kur lind nevoja i përcillen organeve kompetente të huaja.

Kostoja e përlogaritur në total për ngritjen e databazës dhe mirëmbajtjen e saj është llogaritur si më poshtë:

<b>Viti 2021</b>	<b>Viti 2022</b>	<b>Viti 2023</b>
<b>(kosto për ngritjen e sistemit)</b>	<b>(kosto për mirëmbajtjen e sistemit)</b>	<b>(kosto për mirëmbajtjen e sistemit)</b>
<b>16,050,622</b>	<b>3,210,124</b>	<b>3,210,124</b>

## **X. HYRJA NË FUQI E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare

**MINISTRI**  
**ELVA MARAGARITI**